

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt: 31.12.2014, si dhe në bazë të kërkesës **05 nr.350/02-61406/21 dt. 02.04.2021**, të pronarit/Investitorit “Benita Company” sh.p.k., me përfaqësues Negjat dhe Hesen Kalludra nga Klina, rr. Musine Kokollari, Dardani - Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e ndërtesës së përkohshme me destinim për afarizëm, në kuadër të Planit Rregullues “Dardania” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 12.07.2021, merr këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore** pronarit/Investitorit “Benita Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810313213, me pronar dhe përfaqësues fizik Negjat Kalludra dhe Hesen Kalludra nga Klina, sipas kërkesës **05 nr.350/02-61406/21 Dt. 02.04.2021**, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës së përkohshme me destinim për afarizëm, në kuadër të Planit Rregullues “Dardania” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7440-0 ZK Prishtinë.

**II. Lokacioni** i parcelave kadastrale të lartcekura, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të:

Planit Rregullues “Dardania”, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-710, me 05-06.2009 dhe Planit Zhvillimor Urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës nr. 01-035-181427, më 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “afarizëm, tregti, administratë, banim kolektiv, garazhim dhe dhe funksione përcjellëse”.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit - parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqet, pronarët dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
  - nr. 7440-0, me  $S=561m^2$ , me pronar “Benita Company” shpk, “Oborr  $445m^2$  dhe Shtëpi/Ndërtesë  $116 m^2$ ”;
  - Sipërfaqja totale  $S=561m^2$ .
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Bazuar në certifikatën e njësive kadastrale, parcela kadastrale nr.7440-0 është tokë ndërtimore;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.7440-0 ZK Prishtinë, shtrihet ndërtesa individuale banimore, me etazhitet P+0;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi nga drejtimi lindje-perëndim, me disnivel  $\sim 1.5m^2$ ;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është rrugës ekzistuese;

- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa individuale banimore, ndërtesa shumë banesore, ekonomike etj.;

**IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e ndërtesës së përkohshme me destinim për afarizëm, në kuadër të Planit Rregullues "Kalabria" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:**

- Organizimi me qasje në kompleks, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – "zgjidhja urbane", bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohet/ndërtesa e përkohshme me destinim për afarizëm, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Stotale =224.77m<sup>2</sup> mbi tokë

Etazhitet: P+0,

Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas planit rregullues, të jetë për "afarizëm", si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të parkingjeve, etj.(sipas projekt propozimit të prezantuar);

- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, është P+0, kurse i propozuar dhe i miratuar është P+0;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), sipas Rregullorës nr. 01.nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabaritit në përdhese, është max.40%, dhe kjo sipërfaqe për këtë parcelës, duhet të jetë:

**Parcela ndërtimore - Blloku "8b"**

$S = 561 \times 0.4 = 224.40 \text{ m}^2$ ;

$S = 224.00 \text{ m}^2$ ; /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ) është min 40%, sipas planit rregullues, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

**Parcela ndërtimore - Blloku "8b"**

$S = 561 \times 0.4 = 224.40 \text{ m}^2$ ; / lejuar sipas Vendimit 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës/

$S = 224.7 \text{ m}^2$ ; / sipas projekt propozimit/

- Bazuar në kriteret e Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt: 31.12.2014, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, është 0.5H, me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej 1H. Me marrëveshje të fqinjëve, kjo distancë mundet me qenë 1.2m .
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit, nga rruga–niveli i terrenit, të jetë max.0.3m';
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të prezantuar në Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane" të kompleksit;
- Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim (*varësisht nga dokumenti i planifikimit hapësinor*);
- Kompleksi të organizohet edhe me vendparkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotualet etj.;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;

Faqe 2 prej 5

- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a dhe PTK.

VI. **Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zeytare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

VII. **Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të

Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

**IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.**

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

**X. Para aplikimit për leje ndërtimore, me kërkesë të veçantë duhet ti drejtoheni kësaj drejtorie për leje rrënimi për ndërtesën ekzistuese;**

**XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.**

## **A r s y e t i m**

Pronari/Investitori **“Benita Company” sh.p.k.**, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit me nr.810313213, me pronar dhe përfaqësues fizik Negjat Kalludra dhe Hesen Kalludra nga Klina, me kërkesën **05 nr.350/02-61406/21 dt. 02.04.2021**, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e ndërtesës së përkohshme me destinim për afarizëm, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Me kërkesë, pronarët dhe investitori kanë prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 7440-0 ZK Prishtinë, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914059-07440-0 ZK Prishtinë;
- Projektin konceptual-projekti ideor dhe Plani i situacioni - "zgjidha urbane" e ndërtesës së përkohshme me destinim për afarizëm, të hartuar nga "P-Delta" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 71106098;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Xhavit S.FetahuN.Sh. "Geoing";
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të **“Benita Company” sh.p.k** nga Prishtina me nr. nr.810313213;
- “Autorizim i përgjithshëm” të **“Benita Company” sh.p.k** nga Prishtina, dhënë Emin Demaku, vërtetuar te noteri Zyfer Aliu, Lipjan, me LRP.Nr.1412/2021 me datë 12.02.2021;
- Pëlqimin nga BKT, për rrënimin e objektit dhe ndërtimin e objektit të ri, me dt.09.07.2021;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të **“Benita Company” sh.p.k.** nr.54446/21 dt.23.03.2021, lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit-letërnjoftimit të pronarit/investitorit dhe të autorizuarit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës **05 nr.350/02-61406/21 dt. 02.04.2021**, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të

Faqe 4 prej 5

dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Planit Rregullues "Dardania dhe PZHU-së/), rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se: Pronari/Investitori "Benita Company" sh.p.k., me seli në Prishtinë me anë të kërkesës së mëhershme me nr.05-350/02-25290/17 dt. 09.02.2017 i është drejtuar kësaj drejtorie për caktimin e kushteve ndërtimore për parcelën e njëjtë kadastrale me nr.7440-0, ZK.Prishtinë. Dhe bazuar në kërkesën e palës kjo drejti ka caktuar kushtet ndërtimore me 05-350/02-25290/17 dt.24.02.2017 të cilave ju ka skaduar afati ligjor.

Kjo Drejtori në procedurë të shqyrtimit të kërkesës së serishme për caktimin e kushteve ndërtimore / projektit konceptual i prezantuar / dokumentacionit të dorëzuar, ka konstatuar se kërkesa është në harmoni me UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 / kriteret e Planit Rregullues në fuqi dhe Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt:31.12.2014 andaj, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, të MMPH-së, ka vendosur njoftimin me datë 20.05.2021 deri me dt.25.05.2021. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve" dhe Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt: 31.12.2014, Drejtorja e Urbanizmit ka konstatuar se kërkesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban/PZHU-së/PZHK-ë/ për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit -"zgjidhja urbane".

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkesit, **Qendrës për shërbim me qytetarë**, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës **05 nr.350/02-61406/21 dt. 02.04.2021**

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 Nr. 350/02-61406/21 DT. 12.07.2021**

Zyrtari,  
Anije Osmani



u.d. Udhëheqëse e Sektorit  
Mimoza Berisha Prestreshi




DREJTORI,  
Ardian Olluri









Rr. Musine Kokalari

Rr. Musine Kokalari

### Rruga e Asfaltuar

Rr. Enver Gjergjeku

Investitore	BENITA COMPANY	
Kompania	 P-DELTA Str. Adem Lushnjë nr. 10 Prishtinë www.p-delta.com	
Projekti	Projekti detal/ Arkitektura	
Emri i projektit	Administratore/ objekt i perkohshem	
Pembajtja	Situacioni i ngushte	
Projektauesi	M.Sc. arch. Benjamin Kabashi	Perpleja Nr 1:100
	M.Sc. i.d.ndert. Arbon Prekadini	Date Janar 2018
		01